



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
KRYEMINISTRIA  
MINISTËR SHTETI PËR  
PUSHTETIN VENDOR



# TRAJNIME TË ZHVILLUARA PËR PUSHTETIN VENDOR

JANAR – QERSHOR 2024

## TRAJNIMET PËR PUSHTETIN VENDOR 2024


### Trajnimet e komisioneve të përhershme të Këshillave Bashkiakë

Me iniciativë të Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, AMVV në bashkëpunim me SHAV, ASPA, SHKQSH dhe me mbështetjen e Projektit “Bashki të Forta” kanë zhvilluar trajnimet për komisionet e përhershme të këshillave bashkiakë. Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte fuqizimi i rolit të Komisioneve të Këshillave Bashkiake në shqyrtimin e projekt-akteve, vlerësimin e tyre dhe përgatitjen e raporteve për propozimet ndaj këshilltarëve në seancën e këshillit, me qëllim krijimin e këshillave të suksesshëm.


Trajnimet janë zhvilluar në dy faza, ku faza e parë ka patur si objektiv trajnimin e komisioneve të arsimit parashkollor dhe komisionet e shërbimeve publike (menaxhimi i mbetjeve), ndërsa faza e dytë ka patur si objektiv trajnimin e komisioneve të ekonomi-financës dhe komisioneve të barazisë gjinore. Në këto trajnime kanë marrë pjesë 2 këshilltarë nga secili komision për çdo këshill bashkiak, si dhe 1 person nga administrata e secilës bashki për secilin prej funksioneve të sipërpërmendura.

- Trajnimet janë zhvilluar në nivel qarku (**24 trajnime në total**).
- **60 Këshilla bashkiak të trajnuar**
- Trajnimet për komisionet e Këshillit Bashkiak Tiranë nuk janë zhvilluar ende.

TRAJNIMI PËR KOMISIONET E KËSHILLAVE BASHKIAK (ARSIMI PARASHKOLLOR DHE MENAXHIMI I MBETJEVE)



TRAJNIMI PËR KOMISIONET E KËSHILLAVE BASHKIAK (EKONOMI FINANCA - BARAZIA GJINORE)




## TRAJNIMET PËR PUSHTETIN VENDOR 2024

### Trajnimet e komisioneve të Integritimit Evropian të Këshillave Bashkiak

AMVV në bashkëpunim me projektin “Bashkitë për në Evropë”, kanë zhvilluar trajnimet e komisioneve të Integritimit Evropian. Këto trajnime syonin përfshirjen gjithnjë e më të madhe të të zgjedhurve vendorë në proceset e integritimit evropian të vendit dhe përgatijen e autoriteve lokale për sfidat që sjell procesi i negociatave me BE-në.


- 5 trajnime në nivel qarku për bashkitë e qarqeve Berat, Gjirokastrë, Vlorë, Fier dhe Elbasan.
- Numri total i pjesëmarrësve 90



### Trajnimet PRAG

Gjatë periudhës raportuese ka përfunduar cikli i trajnimeve për procedurat e prokurimeve sipas rregullave të BE-së, i cili ka filluar gjatë vitit 2023.

- 61 bashki pjesëmarrëse (100%)




## TRAJNIMET PËR PUSHTETIN VENDOR 2024

### Trajnimi me nivelin e lartë drejtues të bashkive

Gjatë periudhës raportuese AMVV në bashkëpunim me projektin BpE kanë përfunduar ciklin e trajnimeve me Sekretarët e Përgjithshëm dhe Nënkyetarët e bashkive mbi “Bashkitë në Procesin e Integritit Evropian në BE, i cili ka filluar gjatë vitit 2023.


- **61 bashki pjesëmarrëse (100%)**



### Trajnim për Sistemin e Matjes të Performancës

Në kuadër të nismës të Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor për matjen e performancës të bashkive për vitin 2023, AMVV me mbështetjen e projektit “Bashki të Forta”, gjatë muajit shkurt zhvilluan 12 trajnime rajonale me pjesëmarrjen e koordinatorëve të performances të 61 bashkive të vendit. Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte njohja e koordinatorëve me konceptin e performances, indikatorët e përzgjedhur si dhe metodologjinë për mbledhjen e të dhënave.

- **Në këto trajnime morën pjesë 61 nga 61 bashki (100%)**
- **Numri total i pjesëmarrësve ishte 220 pjesëmarrës.**




## TRAJNIMET PËR PUSHTETIN VENDOR 2024

### Trajnim për Arsimin Parashkollor

Në kuadër të përpjekjeve për të mbështetur njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe duke synuar performancë më të mirë të shërbimit të arsimit parashkollor, Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor dhe Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV) me mbështetjen e Projektit “Bashki të Forta”, kanë zhvilluar trajnimet për “Përmirësimin e Menaxhimit të Arsimit Parashkollor”. Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte rritja e kapaciteteve të bashkive mbi modelin e menaxhimit të arsimit parashkollor. Gjatë trajnimit pjesëmarrësit u njohën me proceset që ndodhin në arsimin parashkollor dhe zbatimin e tyre në përputhje me aktet ligjore dhe standartet kombëtare.

- Në këto trajnime morën pjesë **28 bashki**
- **Numri total i pjesëmarrësve 83**



### Trajnim për Kapitalin Natyror të Bashkive

Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor dhe AMVV me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, kanë ndërmarrë një vlerësim metodologjik mbi potencialin e Kapitalit Natyror të Bashkisë (KNB) në Shqipëri. Kapitali Natyror është bërë pjesë e Strategjisë për Decentralizimin dhe Autonominë Vendore 2023-2030 dhe në këtë kontekst, Ministri synon të shtrijë procesin e vlerësimit në të gjitha bashkitë e vendit. Për këtë qëllim, gjatë vitit 2023 OSBE në bashkëpunim të ngushtë me AMVV zhvilluan 4 takime rajonale mbi zhvillimin në mënyrë të pavarur të Vlerësimit të Kapitalit Natyror të Bashkisë. Gjatë periudhës raportuese janë zhvilluar 3 takime rajonale për të trajnuar 24 bashkitë të cilat nuk kanë marrë trajnim gjatë vitit 2023.

- Në 3 takimet kanë marrë pjesë **21 bashki nga 24 bashki të ftuara (87,5%)**, ku numri total i pjesëmarrësve ka qenë **48 pjesëmarrës**.
- **Në total janë trajnuar 58 bashki nga 61 (95%)**

